



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e59-të, të mbajtur më 14.01.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar me nr. 12-1775 / 1 datë 04.05.2021 kundër ish Ministrit -----
-, REFUZOHET.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka juridiksion për të vepruar në rastin në fjalë sepse nuk është në gjendje të ofrojë informata shtesë për pretendimet në denoncim (denoncim anonim).

Lënda me numër 12-1775 të vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Denoncimi është dorëzuar nga një parashtrues i panjohur më 04.05.2021 për personin -----
-----, ish-ministri teknik dhe është krijuar lënda me numër 12-1515 nga 2021. .

Në denoncim, parashtruesi thekson se janë keqpërdorur burimet shtetërore për qëllime elektorale dhe aktivitete partiake, në funksion të fushatës për zgjedhjet e parakohshme

parlamentare dhe në periudhën prej ----- nga ministri teknik i atëhershëm -----

Denoncimi shoqërohet me fotografi të aktiviteteve të publikuara në faqen e Facebook-ut nga ministri i atëhershëm, dhe ato i referohen vizitave në disa vendbanime në rajonin e Strumicës, si dhe në Dojran, Radovish dhe Kavadar. Në denoncim thuhet se ministri teknik me gjasë gjatë vizitave të tilla ka përdorur veturë zyrtare dhe ka gjasa të ketë shfrytëzuar edhe akomodim, ushqim, karburant etj., pasi vizitat kanë qenë për disa ditë dhe me siguri janë paguar nga shteti. buxheti - pa paraqitur anekse shtesë që do të vërtetojnë këto indikacione.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në fjalë, KSHPK-ja ka konstatuar se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të saktësuar pretendimet e denoncuara dhe nuk ka mundësi të ofrojë informata shtesë për pretendimet në denoncim, sepse bëhet fjalë për denoncim anonim, pas së cilës ka vlerësuar se nuk ka elemente të veprimit kompetent për rastin e lëndës.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT
Nënkryetar
Goran Trpenoski

Përgatiti: M.r K.Z, Këshilltar
Miratoi: N.B., Anëtar i KSHPK-së

